



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201300867/20

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** *Rekomandohet përjashtimi nga tatimi i përfitimit suplementar të siguruar nga ish punonjësi i policisë së burgjeve S. M.*

**Drejtuar:** **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**  
Z. Artur ZOTO

**TIRANË**

*I nderuar Z. Zoto,*

Në letërkëmbimin e mëparshëm që keni patur me Institucionin e Avokatit të Popullit jeni njohur me ankesën e shtetasit S. M., ish punonjës i policisë së burgjeve, i cili pretendon se DPBurgjeve nuk ka shlyer plotësisht detyrimin në të holla të vendosur nga Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Detyrimi që duhet të shlyejë DPBurgjeve është shuma në të holla për shpërblimin me dy paga referuese mujore dhe për pagesën kalimtare. Shuma e mbetur pa shlyer është në vlerën 11.900 lekë.

Sipas shpjegime që kemi marrë nga DPBurgjeve, vlera prej 11.900 lekë është vlera e tatimit mbi pagën mujore, sipas Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", neni 8/g dhe neni 8/1. Përfitimet në të holla të marra nëpërmjet vendimeve të gjykatës tatoheshin në datën kur vendimi i gjykatë të shprehur në favor të Z. M. ka marrë formë të prerë.

Pasi analizuam në tërësi legjislacionin e zbatuar për këtë rast rezultoi se, përfitimet në të holla të ish punonjësit të policisë së burgjeve S. M. nuk duhet të tatohen. Këto përfitime parashikohen në nenin 12 të Ligjit Nr. 10142, datë 15.05.2009. Në nenin 6 të këtij ligji përcaktohet se përfitimet nga ky ligj nuk tatohen. Ligji "*Për tatimin mbi të ardhurat*", në kohën kur është shprehur gjykata me vendim për rastin në fjalë, nuk i përjashtonte nga tatimi të ardhurat e marra nga shpërblimi dhe pagesa kalimtare por, as nuk specifikonte nëse këto të ardhura ishin të tatueshme (neni 8 dhe 8/1). Nëse i referohemi praktikës të Gjykatës Kushtetuese, në disa vendime ajo është shprehur për hierarkinë ndërmjet ligjeve. Në rast konflikti normash juridike zbatohen parimet e shtetit të së drejtës dhe të koherencës në sistemin ligjor që, në këtë rast është parimi "*lex specialis derogat generali*", sipas të cilit norma e veçantë ka përparësi nga norma e përgjithshme (vendimet nr.2 dt. 03.02.2010 fq. 7 dhe nr. 16 dt.

27.03.2012 fq. 9). Normat juridike që parashikojnë se, përfitimet suplementare të punonjësve të policisë së burgjeve nuk taten, janë norma të veçanta dhe kanë përparësi në zbatim.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive."

### **J U R E K O M A N D O J M Ë:**

Përrjashtimin nga tatimi të përfitimit suplementar të siguruar nga ish punonjësi i policisë së burgjeve S. M. dhe shlyerjen e shumës së parave në vlerën 11.900 lekë.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

*Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**